



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË OBILIQIT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Obiliqit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit (KO), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Obiliqit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 796,648€, nga kategori ekonomike jo adekuate.
- C1 Nënvlërësimi i pasurive kapitale në Pasqyrat Financiare Vjetore, dhe mbivlrësimi i pasurive jokapitale në vlerë gjithsej 6,750€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Obiliqit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara si rezultat i hyrjes në obligime pa fonde buxhetore.
- B2 Përfituesi i subvencionit nuk kishte dërguar raportin financiar me dëshmitë e kërkuara sipas marrëveshjes për subvencionim.
- A2 Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- A3 Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, si dhe pagesa të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 1,329,361€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 1,053,139€, ndërsa 276,222€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbartimore dhe interesit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Obiliqit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Obiliqit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Obiliqit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Obiliqit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Obiliqit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikimi si rezultat i kontratave kolektive, mos regjistrimi i duhur i pasurive si dhe mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim, mos respektimi i procedurat të prokurimit, ku janë vërejtur dobësi në menaxhimin e kontratave publike, vonesat në kryerjen e punëve, mos raportimi i përfituesve të subvencioneve, mos raportimi i menaxhereve të kontratave në sistemin e-prokurimit, si dhe mungesa e ndërmarrjes së veprimeve në dispozicion për mbledhjen e borxheve.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, dy (2) rekomandime të përsëritura dhe dy (2) rekomandime pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Shuma e pagesave të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarimore ishte 1,329,361€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 1,053,139€, ndërsa 276,222€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbarimi.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve.

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë 796,648€. Nga kjo vlerë, Thesari kishte ekzekutuar sipas vendimeve përmbarimore të Gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për punëtorët nga kategoria investime kapitale 389,616€, nga kategoria mallra dhe shërbime 275,183€ dhe nga kategoria subvencione dhe transfere 131,849€. Pagesat nga kategoritë ekonomike jo adekuate janë ekzekutuar nga Thesari. Në fund të vitit 2024, komuna kishte bërë kërkesës në Ministri për aprovimin e buxhetit shtesë në kategorinë e pagave dhe shtesave, por kjo nuk kishte ndodhur.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për ti realizuar pagesat e vendimeve

gjyqësore përmbartimore.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata të paskata për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e saktë të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Nënvlërësimi i pasurive kapitale në Pasqyrat Financiare Vjetore, dhe mbivlerësimi i pasurive jokapitale.

Gjetja Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1 përcakton se, çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe Neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Kemi vërejtur se në një rast pasuria e blerë nga kodi ekonomik (13505) Pajisje të teknologjisë informative (fotokopjues) me vlerë për njësi mbi 1,000€, nuk është regjistruar në sistemin SIMFK - Moduli Pasuria. Vlera e pa regjistruar dhe e nënvlerësuar e pasurisë kapitale është 6,750€ Duhet të theksojmë gjithashtu që këto pasuri ishin regjistruar në modulën e-pasuria që nënkupton që vlera e pasurive jo kapital ishte mbivlerësuar për 6,750€.

Mangësitë e identifikuar lidhur me regjistrimin dhe prezantimin e pasurisë në Pasqyrat Financiare Vjetore kanë ndodhur për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm dhe mos koordinimit të zyrtarit të pasurisë dhe zyrës së financave në zbatimin e drejtë të rregullores për menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mangësitë e identifikuar në menaxhimin e pasurisë, ndikojnë në menaxhimin jo të mirëfilltë të regjistrave për pasuri dhe në prezantimin jo të saktë dhe të plotë të vlerës së pasurive kapitale dhe jokapitale në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të forcoj kontrollet lidhur me regjistrimin e pasurive për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar në regjistra përkatës, të bëhet azhurnimi i regjistrave kontabël të pasurive përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, si dhe të shpalosen saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara

Gjetja

Neni 9.2 i Ligjit Nr 04/L-042 për prokurimin publik përcakton se “nëse pas vlerësimit të nevojave, Zyrtari Kryesor Administrativ vendos se vlerësimi i nevojave e arsyeton ushtrimin e aktivitetit të prokurimit, Zyrtari Kryesor Administrativ i dërgon një kopje të këtij vlerësimi Zyrtarit Kryesor Financiar të autoritetit kontraktues. Zyrtari Kryesor Financiar siguron se ka mjete financiare në dispozicion për prokurimin përkatës në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publik dhe Përgjegjësitë.

Ne identifikuam mangësi në menaxhimin e kontratave si në vijim:

- Projekti “Vazhdimi i sheshit Adem Preniqi” në vlerë 756,516€, Kontrata ishte nënshkruar më 16.11.2022, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte data 15.11.2023. Mirëpo, me datën 13.11.2023 Menaxheri i kontratës ka njoftuar se punimet ishin ndërprerë për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe mos pagesës së obligimeve ndaj operatorit ekonomik për punët e kryera, ku sipas menaxherit të kontratës deri me këtë datë punimet ishin kryer rreth 80%;
- Projekti “Ndërtimi i dy nënkalimeve për këmbësor” në vlerë 429,348€, Kontrata ishte nënshkruar më 19.07.2023, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte 120 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës. Punët nuk ishin kryer me kohë, për më tepër me datë 08.12.2023 Menaxheri i Kontratës kishte kërkuar shtyrje të afatit me arsyetimin për probleme me infrastrukturën nëntokësore. Kërkesa ishte aprovuar për vazhdim të afatit deri më 08.12.2023. Deri në kohën sa ne ishim në auditim (në fazën e ekzekutimit Prill 2025), sipas menaxherit të kontratës ishin kryer 75% të punëve; dhe
- Projekti “Ndërtimi i brezit të gjelbër - Kosova A” në vlerë 219,798€, Kontrata ishte nënshkruar më 08.12.2022, dhe afati i ekzekutimit të punimeve ishte me afat prej 9 muaj. Për shkak të problemeve buxhetore ishte kërkuar shtyrje e afatit dhe projekti ishte kryer më 04.04.2024, kur ishte bërë pranimi teknik i projektit.

Mos planifikimi i duhur dhe mos siguri i mjaftueshëm i mjeteve financiare ishte shkak që punimet të ndërprehen dhe nuk ishin kryer në pajtueshmëri me kushtet dhe afatet kohore të ekzekutimit të kontratës.

Ndikimi

Mungesa e aprovimeve paraprake të fondeve të mjaftueshme buxhetore për ekzekutimin e projekteve, si dhe mos përmbushja e kontratës sipas kushteve të specifikuara në kontratë tregon se planifikimet buxhetore, por edhe përgatitjet e kontratave kanë dobësi të theksuara duke ndikuar që punët të vonohen dhe mos realizohen siç ishin me kontratë. Për më tepër mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndikuar që të ketë shpenzime shtesë të interesit dhe shpenzime për procedura gjyqësore/përmbartimore.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit së pari të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për financimin e projekteve. Po ashtu, duhet të siguroj që menaxherët e kontratave të mbikëqyrin realizimin e projekteve për të eliminuar të gjitha pengesat që e

pamundësojnë realizimin e kontratës sipas kushteve të parapara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Raportim i mangët nga përfituesit lidhur me subvencionet

Gjetja

Rregullorja nr.1/108 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve në nenin 22 Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve përcakton se „Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar dhe narrativ. Përfituesit e subvencioneve obligohen që pas marrjes së subvencionit të dorëzojnë në komunë raportin me të gjitha shpenzimet financiare ashtu siç janë kërkuar me projekt-propozim. Raporti duhet ti këtë të gjitha shpenzimet e dokumentuara (raportet bankare, faturat e rregullta, nënshkrimet e pjesëmarrësve. Gjithashtu Marrëveshja e bashkëpunimit në mes Komunës dhe Islamic Relief Worldwide (IRW) neni 2 përcakton se fondet e komunës do të transferohen tek IRW, e cila pastaj do të raportoj dhe dëshmoj me faturat e shpenzimeve dhe raportet e shërbimeve të kryera.

Tek projekti trevjeçar i subvencionuar në bashkëfinancim nga Komuna dhe Islamic Relief Worldwide (IRW) “Kujdesi shtëpiak për lehonat, personat e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara” në vlerën e përgjithëshme prej 410,598€, ku komuna participon me 184,783€, në tri (3) pagesa të kontrolluara në vlerë gjithsej 53,455€ kemi identifikuar se raportimi i shpenzimeve të realizuara nga IRW nuk ishte në harmoni me marrëveshjen në mes komunës dhe përfituesit. Kjo ngase, raportimet që lidhen me zbatimin e projektit ishin vetëm për numrin e vizitave mjekësore në një tabelë në excel dhe nuk kishin dëshmi të pagesave dhe shpenzimeve, siç ishte përcaktuar me marrëveshje.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve në monitorimin e subvencioneve, dhe dorëzimit të raporteve narrative dhe financiare nga ana e koordinatorëve përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes.

Ndikimi

Shfrytëzimi i subvencioneve nga përfituesit dhe raportimi i tyre jo në përputhje me marrëveshjen dhe rregulloren komunale, mund të rezultojë me vlerë të dobët të parasë së shpenzuar nga Komuna dhe në mos arritjen e objektivave për subvencionet e dhëna.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e fondeve nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me kërkesat ligjore**Gjetja**

Rregullorja nr. 001/2022 për prokurimin publik pika 54.15 thekson se kurdo që autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

Te katër (4) procedura të prokurimit për kontrata publike kornizë të lidhura me çmimin për njësi, autoriteti kontraktues në kontratat e nënshkruara kishte përfshirë edhe devijimin +-30%, që është në kundërshtim me kërkesat e rregullores së prokurimit publik, rastet janë si në vijim;

- "Furnizimi dhe vendosja e mjeteve sportive dhe rekuizita në institucionet edukativo arsimore", çmimi për njësi 7,015€ me vlerë të kontratës 60,000€.
- "Shtruarja e Rugëve me zhavorr", çmimi për njësi 21.63€ me vlerë të kontratës 150,000€.
- "Hartimi i projekteve", çmimi për njësi 46.62€ me vlerë të kontratës 399,999€, dhe
- "Pastrimi i rrugëve gjatë sezonit dimëror në territorin e Komunës së Obiliqit" çmimi për njësi 288.60€ me vlerë të kontratës 350,000€.

Arsyeja përse kishte ndodhur kjo është mungesa e funksionimit të kontrolleve të brendshme, dhe pakujdesia e zyrës e prokurimit për ti evituar këto çështje.

Ndikimi

Lidhja e kontratës duke aplikuar devijimin +-30%, nuk është në pajtim me kërkesat ligjore, si dhe njëherit kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve shtesë të paarsyeshme dhe të paplanifikuara të parasë publike si dhe mund të ndikon në rritjen e obligimeve komunale.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë se procedura e prokurimit do të zhvillohet në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik, dhe kur autoriteti kontraktues nuk mundë ti planifikoj sasi të indikative me çmim për njësi, atëherë nuk duhet të përfshihet në kontratë edhe devijimi +-30%.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbarimore.**Gjetja**

Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Po ashtu neni 40.3 i Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit parash "Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm ose urdhrit të formës së prerë, Ministria është e autorizuar dhe ka përgjegjësinë që menjëherë të marrë çfarëdo masa të nevojshme për pagimin e vendimit ose urdhrit nga ndarjet buxhetore në dispozicion; me kusht që nëse vendimi i plotfuqishëm është nxjerrë kundër një komune, vetëm përvetësimet e komunës mund të shfrytëzohen për përmbarimin e këtij vendimi".

Në tetë (8) raste të detyrimeve (faturave) të pa paguara në vlerë prej 265,853€ obligimet nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në tri (3) raste ishin nga 90 ditë, ndërsa në pesë (5) rastet tjera vonesat ishin nga mbi 4 muaj.

Po ashtu, për shkak të mos kryerjes së obligimeve me kohë, thesari sipas vendimeve gjyqësore/përmbarimore kishte ekzekutuar pagesa nga buxheti i komunës për vitin 2024 në vlerë prej 1,329,361€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 1,053,139€, ndërsa 276,222€ ishin shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbarimore dhe interesit.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve kanë shkaktuar kosto shtesë, përveç vlerës së faturës komuna kishte paguar kosto shtesë përfshirë kamatën dhe shpenzimet tjera procedurale gjyqësore/përmbarimore.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të përmirësojë performancën e menaxhimit të fondeve, dhe të bëjë planifikim të mirëfilltë, për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmangët shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 6,123,864€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 5,861,299€ apo 96%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e objekteve, rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

Çështja A4 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Komuna menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që të gjithë menaxherët e kontratave të mbajnë dhe arkivojnë të gjitha dokumentet e menaxhimit të kontratave në modulën përkatës të sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Pasqyrat Financiare Vjetore e pasurive kapitale është 66,480,483€, pasurive jokapitale është 129,965€, si dhe e stoqeve 210,821€.

Çështja A5 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja

Rregullorja MF nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 11 paragrafi 1 dhe 3 përcakton se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim.

Në regjistrin e pasurive kapitale me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara si investime në vijim 69 pasuri në vlerë 6,334,063€. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2019-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Ne për këtë çështje ju kemi drejtuar edhe komunës ku na është konfirmuar që në disa raste projektet ishin përfunduar dhe pajisjet ishin pranuar, por pranimi teknik i tyre nuk ishte kryer ende, ndërsa pjesa tjetër e cila është përfunduar deri në vitin 2024 nuk kanë pasur qasje për korigjim.

Mangësitë e identifikuar lidhur me pasurinë e regjistruar si investime në vijim kanë ndodhur për shkak të kontrollit të dobët dhe mos koordinimit të zyrtarit të pasurisë dhe drejtorive përkatëse për investime kapitale në zbatimin e drejtë të rregullores për menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduara, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Kjo sjell mangësi dhe vështirësi në vlerësimin e saktë të pasurive të komunës, duke e bërë të vështirë menaxhimin efektiv dhe të prezantimit të tyre në PFV me vlerën reale pasi nuk zbatohet dhe llogaritet zhvlerësimi i tyre.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna, në PFV-të e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,401,566€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 1,011,726€, dhe të tjerat nga taksat për leje biznesi, taksat nga shitja e banesave dhe nga qiraja komunale, taksat nga shfrytëzimi i pronës publike etj.

Çështja C2 - Mangësi në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Gjetja

Neni 26 i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L- 005 përcakton se: Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 ishin gjithsej 1,401,566€, prej të cilave 1,011,726€ apo 72% ishin për tatimin në pronë. Në krahasim me vitin paraprak, ato ishin ulur për 386,732€, për shkak se menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime duke dërguar kërkesë të inicimit të procedurës përmbarimore, ndaj disa debitorëve për përmbushjen e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë. Megjithatë vlera e këtyre borxheve është ende e lartë dhe komuna duhet të vazhdojë të ndërmarrë veprime për arkëtimin e borxheve.

Megjithatë, Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime tjera lidhur me arkëtimin e borxheve tek kontratat për shfrytëzimin e pronave publike si dhe kontratat e qirasë së banesave, ku parashihet se nëse nuk paguhet qiraja dhe taksat tjera komunale, Autoriteti ka të drejtë shkëputjen e kontratës, ndonëse nuk janë bërë pagesat nga shfrytëzuesit e pronave, komuna nuk ka marrë veprime sipas të drejtave të saj.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së borxheve.

Ndikimi

Mos arkëtimi i borxheve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

Rekomandimi C2

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,248,389	15,050,417	14,653,892	14,117,020	11,755,534
Grante Qeveritare - Buxheti	12,993,144	13,160,031	13,153,929	12,470,533	10,319,764
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	76,464
Të bartura nga viti i kaluar	0	197,478	194,097	312,876	366,512
Të hyrat vetanake	1,255,245	1,255,245	1,031,408	942,285	967,591
Donacionet vendore	0	700	0	30	25,203
Donacionet e jashtme	0	436,963	274,457	391,296	0

Buxheti final i Komunës së Obiliqit është më i lartë se buxheti fillestar për 802,028€. Kjo rritje e buxhetit është i rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje buxhetore në vlerë prej 166,887€, përfshirjes së të hyrave të bartura prej 197,478€ dhe donacioneve në vlerë prej 437,663€, në buxhet final.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar 14,653,892€ ose rreth 97% të buxhetit final, me një rënie prej 1% në raport me vitin e kaluar. Komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ju kanë ekzekutuar 1,329,361€ nga kategori të ndryshme ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,248,389	15,050,417	14,653,892	14,117,020	11,755,534
Pagat dhe mëditjet	5,420,563	5,587,450	5,587,151	5,159,747	4,238,004
Mallrat dhe shërbimet	1,700,000	1,782,402	1,753,351	1,548,521	1,430,204
Komunalitë	300,000	435,861	435,757	268,622	259,195
Subvencionet dhe transferet	1,100,000	1,120,839	1,016,334	996,393	1,090,132
Investimet Kapitale	5,727,826	6,123,864	5,861,299	6,143,736	4,737,999

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 166,887€. Kjo rritje vjen nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr.03/239 i datës 24.12.2024, për mbulimin e pagave që janë paguar përmes vendime gjyqësore përmbarimore për kontratat kolektive.

Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 82,402€.

Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara 15,122€, si dhe rritje nga donacionet për 67,280€.


Buxheti final për shpenzime komunale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 135,861€.

Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje për 20,839€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.

Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar kishte rritje në vlerë prej 396,038€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara 25,655€, si dhe rritje nga donacionet për 370,383€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e planifikuara nga Komuna e Obiliqit në vitin 2024 ishin në vlerë 1,255,245€, ndërsa ishin realizuar 917,253€, apo 73% e planifikimit. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga taksat e legalizimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja, etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjokat në trafik në vlerë prej 312,240€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,255,245	1,255,245	917,253	899,270	1,129,173
Të hyrat tatimore	752,508	752,508	445,530	449,466	423,468
Të hyrat jo tatimore	502,737	502,737	471,723	449,648	705,705
Të hyrat tjera	0	0		156	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Obiliqit ka rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar; dy (2) ishin në proces dhe dy (2) nuk ka filluar zbatimin ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve i kuptojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në angazhimet përkatëse.	Në testimet e mostrave të procedurave të prokurimit nuk kemi hasur raste të tilla, prandaj konkludojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e fondeve nga përfituesit.	Nga testimet e kryera në një rast kemi vërejtur se përfituesi i subvencionit nuk ka dërguar Raporte finaciare dhe dëshmitë e shpenzimeve me të cilat arsyetojnë shfrytëzimin e fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e vlerësimit të kërkesave për subvencionim, ashtu që përzgjedhja e përfituesve të bëhet në përputhje të plotë me kriteret e vendosura në thirrjen publike për subvencionim.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur gabime të tilla, prandaj konkludojmë se rekomandimi është përmbushur.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të forcojë llogaridhënien lidhur me menaxhimin e projekteve kapitale, duke siguruar se për çdo ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, të zbatohen procedurat për marrjen e aprovimeve të duhura sipas rregullave të prokurimit/aplikueshme dhe amendamentimin e kontratës në pajtim me ndryshimet e bëra.	Nga testimet e kryera në asnjë rast nuk kemi hasur në ndryshim në termat dhe kushtet e kontratës, apo amendamentim të kontratës, prandaj konkludojmë se rekomandimi është i zbatuar.	I zbatuar
5.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë që të gjitha pronat pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës. Po ashtu, të sigurojë që të zhvillohen procedurat përkatëse për dhënien e tyre në shfrytëzim.	Nuk kemi hasur në raste të shfrytëzimit të pronave komunale pas përfundimit të kontratës. Komuna ka siguruar një raport monitorimi ku ka bërë identifikimin e pronave, në mars të vitit 2024, ku janë marrë masa konkrete në zhvillimin e procedurave sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar

6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Rekomandimi mbetet i pazbatuar si rezultat i testimit të mostrave ku kemi hasur në keq klasifikim të shpenzimeve nga kategori të ndryshme ekonomike.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerret urdhërblerja dhe më pas të bëhet pranimi i mallrave/punëve.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur gabime të tilla, prandaj konkludojmë se rekomandimi është përmbushur.	I zbatuar
8.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që pasuritë kapitale, pasuritë jokapitale dhe stoqet, regjistrohen dhe raportohen në mënyrë të saktë dhe të plotë, në përputhje me kërkesat ligjore.	Sa i përket aplikimit të zhvlerësimit të e-pasurisë kjo është zbatuar, megjithatë mos regjistrimi i pasurive kapitale është përsëritur edhe këtë vit.	Pjesërisht i zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga obliguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, përfshirë edhe veprimet ligjore.	Gjendja e llogarive të arkëtueshme krahasuar me vitin paraprak është zvogluar, megjithatë nuk janë marrë masa të mjaftueshme në mbledhjen e arkëtueshmeve nga departamentet përkatëse.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të plotësojë stafin e NjAB-së me staf të nevojshëm siç parashihet me kërkesat ligjore, në mënyrë që të arrihet realizimi i planit vjetor të auditimit brenda afateve të përcaktuara, në mënyrë që të ofrohet mbështetja dhe siguria menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontrolleve kyçe. Kryetari duhet të sigurojë se roli, puna dhe misioni i KA po përmbushet në mënyrë që të arrihen objektivat e synuara të Organizatës.	Rekomandimi është zbatuar ngase në vitin 2023, ishte përmbushur plani vjetor i auditimit të brendshëm, ndërsa nuk ka pasur vonesa në raportimin e NjAB në NjQHAB.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Xhevat Seferi, Udhëheqës i ekipit



Valon Halimi, Anëtar i ekipit



Xhevat Hasolli, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Dk. No. 02-104-02-14184-25
Nr. Iq. / Broj. / No. ij. _____
Data / Datum / Date: 28.05.2025
OBILIQ - OBILIČ - OBILIC



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Obiliqit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Xhafer Gashi,
kryetar i komunës Obiliq,

Data: 30 Maj 2025



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.